



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr/16 Datë 30/12/2015

**PËR PJESMARRJE NË THEMELIMIN E SHOQERISE AKSIONERE  
“KONSORCIUMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL” Sh.a**

Këshilli i Qarkut Vlorë, në mbledhjen e datës 30/12/2015, në mbështetje të ligjit Nr. 8652, date 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të Qeverisjes Vendore”, neni 8/VI, neni 54/dh, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, VKM Nr.271, date 08.05.1998 “Për miratimin e statutit TIP të Shoqërive Anonime Shtetërore”, VKM Nr 678 ,datë 03.10.2007 “Për një shtesë në VKM Nr. 271, datë 08.05.1998 “Për miratimin e statutit TIP të Shoqërive Anonime Shtetërore”, VKM Nr. 642, date 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrëse të Shoqërive Anonime Shtetërore”, VKM Nr. 677, date 03.10.2007 “ Për shtesa dhe ndryshime në 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrëse të Shoqërive Anonime Shtetërore”, pasi mori në konsideratë kërkesën e bërë nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë

**VENDOSI**

- 1) Pjesëmarrjen në themelimin e Shoqërisë aksionere “KONSORCIUMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL“ Sh.A, në vlerën 3 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 2) Vlera e kapitalit të vendosur nga Këshilli i Qarkut Vlorë, numri i aksioneve dhe vlera nominale e tyre do të përcaktohet pasi të jenë dakordësuar me aksionerët e tjerë për vlerën e kapitalit të shoqërisë së krijuar.
- 3) Miratimi i Statutit dhe Aktit te Themelimit të Shoqërisë aksionere “KONSORCIUMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL“ sh.a bashkëlidhur këtij vendimi.
- 4) Themelimi, organizimi e funksionimi i shoqërisë aksionere “KONSORCIUMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL “ sh.a i nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi.
- 5) Për vazhdimin e procedurave për regjistrimin, organizimin, përfaqësimin dhe funksionimin e kësaj Shoqërie aksionere “KONSORCIUMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL“ sh.a ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë.
- 6) Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 8652 date 31.07.2000 neni 55 pika 3.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlore



Sadrit Danaj

Shpallur me dt. \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_ me nr. \_\_\_\_\_ nga Prefekti i Qarkut Vlorë

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi “4 Heronjtë”, Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 600